

Nga viti 2008-2009 luan në Orkestrën e RTSH-së e më pas në atë të TKOB. Ka marre mësim me pedagogë të njohur si M. Svoboda (Austria), M. Burghaier (Gjermani), U. Diekersen (Gjermani), E. Scuros (Greqi), G. Corti (Itali), R. Onhill (dirigjent i Orkestrës së BBC). Është fitues i çmimit Absolut në Festivalin Ndërkombëtar "Arts Kosova 2013". Në Tetor të 2014 është ftuar në Beograd për të mbajtur masterclass me studentë të klases së tunxhit të Universitetit të Areve dhe me studentë të shkollave të mesme. Aktualisht Ilir Kodhima është kornist i parë pranë Orkestrës Simfonike të TKOB-së si dhe pedagog i ftuar në Universitetin e Arteve.

### **Erenik Behlula**

I lindur në Tiranë, ndjek studimet në klasën e klarinetës në Liceun Artistik Jordan Misja dhe më pas në Akademinë e Arteve me Pedagog Kaco Dako. Në Tetor 2002 zhvillon disa koncerte me muzikë dhome ku interpreton vepra nga autorë të ndryshëm si Weber, Brahms etj. Që prej 2011 është pjesë e Nonetit të Primarëve dhe disa formacioneve të muzikës së dhomes me të cilët ka interpretuar vepra nga George Onslow, Rehinberger, Mozart, Korsakov etj. Që prej 2002 është klarinetist i Orkestrës së TKOB.

### **Merita Rexha Tërshana**

Ka kryer studimet në Tiranë dhe më pas ka ndjekur kurse specializimi në Gjermani me pianistë të njohur si Paul Badura-Skoda, Till Engel, etj. Ka interpretuar si soliste dhe në muzikë dhome në Gjermani, Austri, Danimarkë, Itali, Zvicër, Greqi, Maqedoni, Kosove. Është fituesja e çmimit "Kult" interpretuesja më e mirë e vitit 2010. Është pedagoge në katedrën e pianos në Universitetin e Arteve dhe ka titullin Profesor i asociuar.

### **Erik Tauzi**

Lindur në Gjirokastrë më 06 Qershor 1979. Fillon studimet për piano në Shkollën «Dëshmorët e Lirisë» e më pas vazhdon studimet për Oboe në Liceun Artistik «Jordan Misja» në klasën e profesor Bledi Shehu. Studimet e Larta i kryen në Akademinë e Arteve në klasën e prof. Ilir Mertiri në vitin 2003. Gjatë studimeve përfundimtare aktivizohet si oboist në orkestrën e Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit. Pas diplomimit emerohet Oboist pranë kësaj orkestre. Ka bashkëpunuar me dirigjentë si: Martin Andre, Vito Clemente, Paul Weigold, Martin Zeller, Fabio Pirona, Bujar Llapaj, Ermir Krantja, Petrika Afëjzollit, Alqi Lepuri, John Yaffe, Francesco Angelico, Andre Bernard, Marco Berdondini, Manfred Mayhoffer, Gianna Fratta, Ekhart Wyscik, Leonardo Quadrini, Vittorio Parisi, Zhani Ciko, Stefano Ligoratti, etj.



Datë 13 Prill 2015, Ora 20.00

# Mozart

(Quintet for Piano and Winds in E Flat, K 452)

# Christian Sinding

Frühlingsrauschen (Eufoni Piano-coro)

# Beethoven

(Quintet for Piano and Winds in E Flat, Opus 16)

Interpretojnë:

Merita Rexha Tërshana (Piano)

Orges Malaj (Fagot)

Ilir Kodhima (Korno)

Erenik Behlula (Klarinetë)

Erik Tauzi (Oboe)



Për prenotime: Tel: 04 222 4753 E-mail: marketing.akordini@tkob.gov.al Web: www.tkob.gov.al



## Mozart

### Quintet for Piano and Winds in E Flat, K 452



Quintet në E flat major për Piano and Winds, është kompozuar nga Wolfgang Amadeus Mozart në 30 Mars, 1784 dhe është interpretuar 2 ditë më pas në Teatrin Kombëtar të Oborrit Mbretëror në Vjenë. Pak kohë pas premierës, Mozart i ka shkruar të atit duke i thënë "Për mua është pjesa më e bukur që kam shkruar në jetën time".

Vepra përmban 3 kohë:

- Largo - Allegro moderato
- Larghetto
- Allegretto

## Christian Sinding

### Frühlingsrauschen (Eufori Pranverore)



Frühlingsrauschen, Op. 32, Nr. 3 (Eufori Pranverore) është një pjesë për piano solo, e shkruar nga kompozitori norvegjez Christian Sinding (1856–1941) në vitin 1896. Është pjesa më e njohur e këtij kompozitori dhe është shkruar me një stil argëtues, duke e bërë shumë të njohur kryesisht në SHBA.

Duke qënë një pjesë shumë atraktive dhe impresionuese, ajo është përfshirë në repertorin e shumë pinaistëve në të gjithë botën si dhe ka shërbyer si kolonë zanore në shumë produksione televizive.

## Beethoven

### Quintet in E flat major for Piano and Winds



Quintet në E flat major për Piano and Winds, Op 16, është kompozuar nga Beethoven në 1796 dhe është i vetmi kompozim për këtë lloj formacioni muzikor. Kjo vepër thuhet që është krijuar sipas modelit të Kuintetit të Mozart, K. 452, e cila është shkruar për të njëjtin formacion. Mozart ishte një kompozitor i mirënjohur në kohën kur Kuinteti i tij u interpretua, ndërkohë që

Beethoven në moshën 26 vjeçare ishte më shumë i njohur për aftësitë e tij improvizuese dhe virtuozitetin në piano sesa për veprat e shkruara kështu që Op 16 ishte një mundësi për të treguar aftësitë e tij në kompozicion. Vepra përmban tre kohë:

- Grave - Allegro ma non troppo
- Andante cantabile
- Rondo: Allegro ma non troppo

## Bio Interpretët

### Orges Malaj

Lindi më 1985 në Fier. Pas përfundimit të studimeve në Liceun Artistik Jakov Xoxa me Pedagogun Kristaq Lena, vazhdon studimet e larta në Akademinë e Arteve me Pedagogun Fatos Jaho dhe përfundon studimet me nota maksimale. Në 2008 është fitues i cmimit të parë Diploma më e mirë e vitit 2008 të Fakultetit të Muzikës. Në 2006 fitues i cmimit të parë të Konkursit Pjetër Gaci, në 2003 fitues i çmimit të parë i konkursit të shkollave artistike të Republikës së Shqipërisë. Në Dhjetor të 2014 zhvillon një Master Clas në Amsterdam Hollandë me Profesorin Gustavo Nunes ku vlerësohet me nota maksimale. Që prej 2006 është Fagotisti i parë i Orkestrës Simfonike të T.K.O.B.

### Ilir Kodhima

Lindi më 1986 në Tiranë. Pas përfundimit të studimeve në Liceun Artistik "Jordan Misja" me Pedagogun A. Dajko, vazhdon studimet në Akademinë e Arteve me Pedagogun Andrea Canaj dhe përfundon studimet me nota maksimale.